

Udhëzues

*PËR
NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E
NjËSIVE TË BRENDËSHME TË SIGURIMIT
TË CILËSISË (NjBSC)
NË INSTITUCIONET e ARSIMIT TË LARTË*

Përmbajtja

A.	Udhëzime mbi Ngritjen e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri	4
1.	Veçoritë karakteristike të Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.....	4
2.	Parimet kryesore operacionale Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	5
2.b	Parimet operacionale të NJBSC-ve	5
3.	Organizimi i NJBSC-së	6
4.	Qëllimet e NJBSC-së	7
5.	Rolet dhe funksionet e NJBSC-së.....	7
7.	Përfshirja e palëve të Interesuara.....	9
8.	Manuali i Sigurimit të Cilësisë	10
II.	Sigurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies	11
1.	Qasja e bazuar tek rezultati dhe procesi	11
2.	Sigurimi i Cilësisë dhe qasja e të mësuarit me përqëndrim tek rezultati	12
3.	Informacioni për Studentët dhe një komunitet me te gjërë.....	15
III.	Hartimi, miratimi, monitorimi dhe vlerësimi i programeve akademike.....	16
1.	Hartimi dhe miratimi i programeve akademike	16
2.	Monitorimi dhe rishikimi i programeve akademike.....	20

PARATHËNIE

Në bazë të ligjit të arsimit të lartë Nr. 9741, dt. 21.07.2007, i ndryshuar, institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ligji parashikon ngritjen e një njësie të brendshme të sigurimit të cilësisë (NJBSC) dhe vendos disa standarde mbi përbërjen, funksionimin, pavarësinë, organizimin, publikimin e raporteve të vlerësimit dhe organet përgjegjëse. Sipas parashikimeve ligjore këto standarde duhet të merren parasysh në hartimin statutit të institucionit të arsimit të lartë. Përmbushja e këtyre kërkesave dhe standardeve ligjore mbi qenësinë e NJBSC, janë ndër kushtet paraprake për një proces të suksesshëm akreditimi.

Bazuar mbi kompetencat që ligji i arsimit të lartë (neni 59, pika 2) i njej Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, APAAL ka marrë nismën të përgatisë këtë Udhëzues për të lehtësuar procesin dhe nxitur krijimin e Njërive të Brendshme të Sigurimit të Cilësië.

Qasja kryesore e këtij udhëzuesi është të rekomandojë disa standarde dhe praktika të mirënjohura evropiane (Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë) për krijimin e NJBSC-ve në institucionet e arsimit të lartë. Synimi parësor i këtij materiali është të ndihmojë NJBSC-të në zhvillimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, që do të ndikojnë në përmirësimin e menaxhimit, cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies, dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj studentëve dhe personelit akademik.

Udhëzuesi ndër të tjera trajton me përparësi në hollësi kyçe si më vijon:

- Aspektin analitik dhe teorike të sigurimit të cilësisë;
- Aspektin operacional, duke paraqitur hapat në rishikimin dhe përmirësimin e sistemeve të brendshme të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë;
- Sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies për të sjellë praktika mësimore që kane studentein në qendër dhe që bazohen tek rezultati;
- Sigurimin e cilësisë së programeve akademike.

I. Udhëzime mbi ngritjen e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri

1. Veçoritë karakteristike të Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

1.1 Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri (IALS) synon një qasje sistematike dhe metodologjike të qartë rreth procesit dhe rezultatit, për të siguruar efikasitet në arritjet dhe efektivitet në proceset e përcaktuara nga misioni institucional. Një qasje e tillë me ontologjinë dhe metodologjitë përkatëse përfshin dy elementë kryesorë:

- *Sigurimi i cilësisë* - merret kryesisht me proceset e ndërmarra nga një institucion. Monitorimi dhe sigurimi i cilësisë duhet të garantojnë që sistemet të zhvillohen dhe të respektohen në mënyrë të tillë që rezultatet të jenë në cilësinë e pritur.
- *Kontrolli i cilësisë* - merret kryesisht me rezultatet. Kontrolli i cilësisë është një qasje e bazuar në produkt. Ai kontrollon nëse rezultatet plotësojnë kërkesat e pritura të cilësisë. Në varësi të rezultateve, ndërmerren dhe veprime të përshtatshme korigjuese nga personeli i kontrollit të cilësisë.

1.2 Çdo proces dhe nënproces brenda mësimdhënies dhe të nxënies duhet të menaxhohet përmes metodës së menaxhimit të cilësisë PDCA (**P**lan, **D**o, **C**ontrol, **A**ct).

- **P** (të planifikojë) – grumbullimin e të dhënave për të identifikuar dhe përcaktuar çështjet / problemet që kanë nevojë për përmirësim dhe për të gjetur mënyrat për t'i arritur ato.
- **D** (të bëjë) – zbatimin e planit duke përdorur një simulim të drejtuar, një testim në grup, etj.
- **C** (të kontrollojë) – analizimin e rezultateve për të parë nëse ekziston një marrëveshje e mirë midis qëllimeve origjinale dhe çfarë është arritur faktikisht; të bëjë ndryshime nëse është e nevojshme.
- **A** (të veprojë) – sipas planit dhe të vazhdojë punën e mëtejshme hap pas hapi në varësi të rezultatit të nxjerrë nga kontrolli në shkallë të gjerë.

1.2 Të gjitha aktivitetet në lidhje me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë duhet të respektojnë qëllimin kryesor, që nënkupton misionin dhe dëshmitë e marra nëpërmjet zbatimit të metodologjisë së sigurimit të cilësisë.

2. Parimet kryesore operacionale të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë

Sigurimi i cilësisë së sistemit, proceseve dhe aktiviteteve në IAL-tështë formuar dhe përforcuar nga një numër parimesh kyç, të bazuara mbi Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe Ligjin e Arsimit të Lartë 2007.

2.a Parimet dhe standardet

Parimet dhe standardet e përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë 2007, Neni 59, Neni 14 etj., janë si më poshtë.:

- i. Themelimin e **Njësisë së posaçme**: Ligji parashikon ngritjen e një njësie përkatëse të sigurimit të brendshëm të cilësisë;
- ii. **Përbërja**: Institucioni e përcakton në statut përbërjen e kësaj njësie Por në përbërje të jenë edhe një përfaqësues nga organizimet studentore dhe një ekspert i jashtëm.
- iii. **Funksionimi**: Njësia kryen “vlerësimin periodik të efikasitetit të veprimtarive mësimore, kërkimore apo artistike, si edhe të veprimtarive administrative e financiare të institucionit”. Institucioni deklaron se kur kryhet ky vlerësim periodik.
- iv. **Pavarësia**: “autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.”;
- v. **Organizimi**: “kriteret dhe procedurat për ngritjen dhe funksionimin e këtij sistemi hartohen nga institucionet e arsimit të lartë, në bashkëpunim me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe përcaktohen në statutet e institucioneve”;
- vi. **Publikimi i vlerësimit**: Institucionet e arsimit të lartë publikojnë rezultatet e vlerësimit që kryejnë;
- vii. **Organi Përgjegjës**: Senati akademik. Neni 14/ë “vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore”;

2.b Parimet operacionale të NJBSC-ve

Duke marrë parasysh parimet ligjore dhe ato të Standardeve dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, parimet operacionale të NJBSC-ve janë si më poshtë:

- Të mbështesë praktikën e rregullt reflektuese nga ana e personelit, ekipeve të mësimdhënies dhe menaxherëve akademike;
- Të vlerësojë përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të mësuarit me qëllim që të promovojë një student interaktiv;
- Të krijojë një kulturë të përmirësimit dhe rritjes së vazhdueshme;

- Të përfshijë kërkesat ligjore të autoriteteve profesionale, kur është e zbatueshme;
- Të lehtësojë komunikimin e nevojave dhe prioriteteve të të dy palëve brenda hierarkisë akademike apo administrative nisur nga “poshtë lart” dhe nga “lart poshtë”;
- Të përqendrohet tek konsumatorët përmes adresimit të nevojave të studentëve, të tregut të punës dhe ndaj shoqërisë në përgjithësi;
- Të angazhohen aktorët në proceset për sigurimin e cilësisë në universitete;
- Të angazhohen studentët si partner pjesëmarrës në menaxhimin e përvojës së tyre;
- Të angazhohen punëdhënësit dhe studentët si ekzekutues të drejtëpërdrejtë të politikave dhe procedurave;
- Të publikohen aspektet në kuadrin e sigurimit të cilësisë përmes përfshirjes së vlerësuesve (peer review) të brendshëm dhe të jashtëm;
- Proceset dhe aktivitetet për sigurimin e cilësisë duhet të bazohen mbi evidencë dhe, sipas rastit, të përfshijnë elemente të ndërgjegjësimit të riskut dhe të menaxhimit;
- Përmirësimi i vazhdueshëm për t’iu përgjigjur nevojave të ndryshme nëpërmjet njohjes së metodave të reja të vlerësimit dhe angazhimit;
- Të hartohet një kornizë e sigurimit të cilësisë, e cila të formohet nga vetëvlerësimi dhe refleksione të shpeshta.

3. Organizimi i NJBSC-së

- 3.1 Sigurimi i brendshëm i cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë duhet të marrë formën e një zyre qendrore me staf të specializuar, që vendos dhe menaxhon një rrjet të sigurimit të cilësisë në të gjitha fakultetet, departamentet dhe njësi të tjera të universitetit.
- 3.2 Angazhimi i drejtuesve të lartë për këtë proces është parakusht për të arritur suksese në sigurimin e brendshëm të cilësisë.
- 3.3 NJBSC duhet jetë një organi i pavaruar dhe duhet të raportojë në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë (nëpërmjet zëvendës-vektorit) tek rektori, duke shmangur në këtë mënyrë ndikimin e fakulteteve.
- 3.4 NJBSC-ja duhet të veprojë në përputhje me Kartën, me Planin Strategjik dhe me Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të miratuar nga Bordi Drejtues i IAL-ës përkatëse.
- 3.5 NJBSC-ja nuk duhet të jetë as një strukturë hierarkike dhe as vetëm një regjistër-mbajës ushtrimesh në institucion; ai duhet të jetë një organ ndihmues dhe pjesëmarrës i institucioneve, si edhe një forcë shtytëse për rritjen e cilësisë duke zhvilluar strategji për të eliminuar mangësitë dhe për të përmirësuar dispozitat arsimore.

4. Qëllimet e NJBSC-ës-së

Qëllimet e NJBSC-ës-së duhet të proaktive dhe të evoluojnë rreth:

- Zhvillimit të një sistemi cilësie për veprim të ndërgjegjshëm, të përputhshëm dhe vazhdimësisht të programuar për të përmirësuar gjithëherazi performancën akademike dhe administrative të IAL-së;
- Promovimit të masave për funksionimin institucional që synojnë përmirësimin e cilësisë përmes ndërkombëtarizimit të kulturës cilësore dhe institucionalizimit të praktikave më të mira.

5. Rolet dhe funksionet e NJBSC-së

5.1 Rolet kryesore të NJBSC-së duhet të jenë si më poshtë:

- **Prodhimi i një raporti vjetor vetevlerësimi.** Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një nga elementet kryesore të procesit të administrimit arsimor, të cilin fakultetet dhe institucionet e arsimit të lartë duhet ta kryejnë sistematikisht dhe në mënyrë të vazhdueshme. Në përfundim, institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin një raport vjetor, i cili vlerëson cilësinë e brendshme mësimore. Raporti të shpallet publikisht. NJBSC-ja kontrollon dhe vlerëson praktikën e fakulteteve dhe njësive të një institucioni në bazë të sistemit dhe mekanizmit të hartuar nga vete institucionet, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet e bazuara në treguesit e të gjithë komponentëve të cilësisë sipas kriterëve dhe standarteve të paracaktuara.
- **Rritja e ndërgjësimit të brendshëm për çështjet e cilësisë:** NJBSC-ja ka si funksion të rrisë vetëdijen e fakulteteve dhe njësive arsimore për statusin e tyre, procedurat që përcaktojnë metodat për zhvillimin e programeve të zhvillimit të cilësisë dhe instrumentet e përdorur për të arritur objektivat dhe qëllimet e vendosura. Në veçanti, NJBSC-ja duhet të udhëzojë fakultetet dhe njësitë arsimore për të kuptuar pikat e forta dhe dobësitë e tyre. NJBSC-ja paraqet gjithashtu sugjerimet përkatëse për përmirësimin e operacioneve dhe fuqizuar pikat e forta e eliminuar pikat që janë vazhdimisht të dobëta.
- **Krijimi i kredibilitetit për vlerësimin e jashtëm:** Roli i NJBSC-së është të sigurojë besueshmërinë për vlerësimin e jashtëm duke lidhur raportet universitare dhe raportet vjetore të vetevlerësimit me sigurimin e jashtëm të cilësisë, pasi që të dy këto raporte përbëjnë dokumentacionin bazë të vlerësimit për vizitën në terren të agjencisë së vlerësimit të jashtëm.
- **Trajnimi dhe zhvillimi:** janë elemente të rëndësishëm në funksion të çështjeve të cilësisë si edhe kompetencave të tjera funksionale të personelit akademik, jo-akademik, studentëve dhe subjekteve të tjerë.

5.2 Funksionet e NJBSC

NJBSC-ja ka funksione shumëdimensionale dhe duhet t'i shërbejë parimeve të përcaktuara më poshtë:

- *Mbështetje dhe sigurim i kërkimeve:* Zyrtarët e SC-së duhet të vizitojnë rregullisht çdo fakultet dhe çdo departament dhe ftohen nga ana e tyre për të zhvilluar kërkime për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Në veçanti, kërkimet, në mënyrë shprehimore, duhet të evoluojnë rreth zhvillimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë, duke vlerësuar përdorimin e mësimdhënies moderne, të mësuarit dhe metodat e vlerësimit të studentëve, me qëllim për të promovuar një qasje interaktive me studentin në qendër.
- *Koordinimi:* meqënëse fakultetet, departamentet dhe njësitë e tjera janë të përfshira në rrjetin e sigurimit të cilësisë, NJBSC-ja duhet të koordinojë proceset e vlerësimit të organizuar prej saj, p.sh. grumbullimi i të dhënave apo analizave.
- *Interpretimi i detyrimeve kombëtare dhe evropiane për sigurimin e cilësisë:* një nga detyrat e NSJBC-së është të interpretojë kriteret kombëtare dhe evropiane të sigurimit të cilësisë për t'i përshtatur ato në kontekstin e saj institucional. NJBSC-ja se duhet të sigurojë që këto detyrime kombëtare dhe evropiane të jenë të ngulitura në praktikën e punës dhe pjesë e jetës së IAL-ës.
- *Monitorimi:* Njësia harton udhëzime për mbikqyrjen mbledhi informacione, dhe ofron alternative për zgjidhjen e problemeve.
- *Administrimi:* Njësia duhet të organizojë dhe të përgatisë (së bashku me APAAL) vizitat e vlerësimit të jashtëm dhe pyetësorët e procesit institucional. Për këto qëllime NJBSC-ja duhet:
 - të hartojë një manual (udhëzues) procedural për të përshkruar strukturën e institucionit dhe proceset për sigurimin e cilësisë; të specifikojë kriteret për zgjedhjen dhe formatet e treguesve, standarteve dhe objektivave; të përgatisë formatet standarde për çështje të tilla si sondazhe studentore dhe pasuniversitare; si dhe të këshillojë për procedurat operative për planifikimin dhe zbatimin e proceseve të cilësisë;
 - të mbledhë sistematikisht dhe të ruajë raportet mbi ecurinë, përfshi të dhënat mbi treguesit dhe objektivat që do të kërkohen për analizat, si edhe të raportojë mbi prijet në punë dhe ndryshimet në mjedisin institucional në të cilin vepron institucioni.
- *Lehtësimi:* NJBSC-ja duhet të lehtësojë krijimin e një mjedisi të përqëndruar tek studenti, të favorshëm për një arsimim cilësor. Njësia mbështet përpjekjet për forcimin e personelit akademik dhe për të përvetësuar njohuritë dhe teknologjitë e kërkuara për pjesëmarrjen në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

- *Sigurimi i informacionit mbi cilësinë*: Njësia merr përsipër shpërndarjen e informacionit mbi parametrat e ndryshëm të cilësisë të institucionit për palët e interesuara të brendshme dhe të jashtme.

6. Administrimi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

- 6.1 Administrimi i sigurimit të cilësisë duhet të shprehet përmes krijimit të bordeve në të gjitha nivelet e IAL-s – nivel qendror, nivel fakulteti, nivel departamenti;
- 6.2 Për administrimin e sigurimit të cilësisë është e nevojshme të vendosen proceset për të analizuar rezultatet, formulimin e rekomandimeve dhe diskutimin e tyre nëpërmjet bordeve të ndryshme (departamenteve, fakulteteve, universitetit, përfshirë bordet drejtuese);
- 6.3 Një Bord Drejtues i veçantë ngrihet në nivel institucional në rast se vlerësimi ka të bëjë me IAL-n në përgjithësi dhe në nivel fakulteti nëse vlerësimi ka të bëjë me një program akademik nën shqyrtim;
- 6.4 Vetë-vlerësimi i IAL-ve në përgjithësi dhe i programeve akademike në veçanti kryhet çdo vit;
- 6.5 Duke u bazuar në raportet vjetore të vetë-vlerësimit për pesë vitet e fundit radhazi, IAL-ja të përgatisë një raport vetë-vlerësimi për vlerësimin e jashtëm;
- 6.6 Për të mbyllur ciklin e komenteve, rezultatet vjetore të vetë-vlerësimit përfshihen si reflektime dhe rezultate në planet e zhvillimit vjetor dhe planet strategjike;
- 6.7 Raportet e vetë-vlerësimit duhet të miratohen nga organi statutor i institucioneve, Bordi Drejtues, për veprimet pasuese për marrjen e masave të nevojshme për rritjen e cilësisë;
- 6.8 NJBSC-ja të ketë prezantimin e saj ekskluziv në internetit të institucionit për të raportuar rregullisht mbi aktivitetet e veta dhe për të bërë publike raportet e vetë-vlerësimit.

7. Përfshirja e Palëve të Interesuara

- 7.1 Aktorët e arsimit të lartë duhet të shihen si një nga elementët më të rëndësishëm në sigurimin e cilësisë së brendshme të IAL-ve. Për të nxitur pjesëmarrjen pro-aktive në sigurimin e brendshëm të cilësisë të një sërë aktorëve të interesuar në sistemin e arsimit të lartë, të përcaktohen mekanizma të veçantë për përfshirjen dhe angazhimin e tyre.
- 7.2 Ka dy lloje grupesh interesi: të brendshëm dhe të jashtëm. Aktorët e brendshëm janë: personeli akademik, studentët, stafi administrativ, menaxhimi i lartë e i mesëm dhe autoritetet e arsimit të lartë. Palët e jashtme janë studentët e diplomuar dhe punëdhënësit.
- 7.3 Përfshirja e palëve të jashtme, studentëve dhe punëdhënësve, është vendimtare për të identifikuar nevojat e tregut të punës dhe nxitjen e kualifikimeve për nevojat e tregut.

7.4 Përfshirja e palëve të interesuara duhet të bëhet në një formë të tillë, që të përfshihet drejtpërsedrejt në të dyja drejtimet, në komisionet e sigurimit të cilësisë dhe nëpërmjet metodave të tilla si sondazhet, takimet, intervistat dhe diskutimet e përgjithshme të rezultateve të marra nga proceset e sigurimit të cilësisë. Kështu, si Bordi Drejtues ashtu dhe bordet e Sigurimit të Cilësisë në fakultet dhe në departamentet e niveleve të ndryshme duhet të kenë së paku një përfaqësues për çdo grup të interesuarish për të informuar mbi trendet dhe kërkesat e tregut të punës.

7.5 Primare në përfshirjen e palëve në bordet e sigurimit të cilësisë dhe Bordin Drejtues, është që ky i fundit të jetë i trajnuar për të nxitur qasjen pro-aktive ndër pjesëmarrësit e këtij procesi. NJBSC-ja është përgjegjëse për përgatitjen e aktorëve që kontribuojnë në sigurimin e cilësisë.

8. Manuali i Sigurimit të Cilësisë

Sipas Standardit 1 në sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e Arsimit të Lartë (Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë) universitetet duhet të kenë politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në vënd. Kështu:

8.1 IAL-ët të zhvillojnë, të mbajnë dhe të ndjekin një Manual për Sigurimin e Cilësisë (MSC). Manuali duhet të jetë dokumenti kryesor për të përshkruar dhe standardizuar të gjitha operacionet akademike dhe funksionale të institucionit.

8.2 MSC-ja duhet të përshkruajë strukturat, politikat, procedurat, masat e performancës dhe mekanizmat t sigurimit të cilësisë që lehtësojnë një qasje sistematike në përmirësimin e cilësisë për dispozitat arsimore. Kështu, duhet që MSC-ja, ndër të tjera, të fokusohet tek:

- Strukturat, rolet dhe përgjegjësitë organizative;
- Politikat akademike;
- Procedurat akademike dhe organizative;
- Vlerësimi i procedurave;
- Shqyrtimi i procedurave të SC-së;
- Mekanizmat dhe mjetet e SC-së;
- Procedura të hollësishme për:
 - Vlerësimin e programeve të reja mësimore,
 - Monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin efikas te programeve akademike,
 - Vlerësimin e studentëve,
 - Vazhdimësinë në monitorimin e programeve,
 - Vlerësimin e çdo programi në intervale të rregullta,

- Zgjedhjen, emërimin, vlerësimin, dhe zhvillimin profesional të stafit akademik,
- Vlerësimin e godinave, pajisjeve dhe objekteve,
- Vlerësimin efektshmërinë së procedurave të sigurimit të cilësisë.

8.3 MSC-ja të jetë publike dhe në dispozicion për të gjithë palët e interesuara.

II. Sigurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies

1. Qasja e bazuar tek rezultati dhe procesi

- 1.1 Qasja e sigurimit të cilësisë dhe kontrollit të mësimdhënies dhe mësimnxënies bazohet tek rezultatet dhe proceset e synuara për mësimdhënien dhe mësimnxënien, si dhe arritjen e rezultateve të synuara të të nxënit.
- 1.2 IAL-t duhet të përdorin vetëvlerësimin si një nga metodat për të shqyrtuar proceset e drejtuara nga institucioni dhe rezultatet që rrjedhin prej tyre. Vetëvlerësimi është një rishikim gjithëpërfshirës, sistematik dhe i rregullt i rezultateve dhe aktiviteteve të organizatës, i cili nxjerr në pah pikat më të forta dhe aspektet që kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme.
- 1.3 Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies duhet të përfshijë tre perspektiva kryesore:
 - shkallën e kënaqësisë së palëve të interesuara nga shërbimet e ofruara nga institucioni ;
 - shkallën në të cilën janë arritur rezultatet e synuara të mësimin;
 - shkallën në të cilën sigurimi i cilësisë në mënyrë të qartë vlerëson përdorimin e metodave moderne të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe qasjen ndërvepruese dhe pyetësore me studentin në qendër.
- 1.4 Dimensionet e cilësisë, të cilat janë objekt vlerësimi për mësimdhënien dhe të të nxënurit, duhet të zhvillohen rreth kompetencave, qëndrimit, përmbajtjes, ofrimit, besueshmërisë dhe rreth asaj se sa të prekshme janë kualifikimet të dhëna.
- 1.5 Identifikimi i mjeteve dhe mekanizmave të nevojshme të sigurimit të cilësisë që i shërbejnë më mirë eksplorimit të nevojave të programit universitar/akademik duhet të bëhet nëpërmjet politikave, procedurave dhe proceseve përkatëse si dhe mekanizmave reaguese ndaj proceseve që i nënshtrohen vlerësimin. Kjo mundëson identifikimin e zbrazëtirave përgjatë dimensioneve të mësipërme të Cilësisë.
- 1.6 Pas identifikimit të mjeteve dhe mekanizmave të nevojshme të sigurimit të cilësisë se një procesi të caktuar, komisionet duhet të vazhdojnë me identifikimin e treguesve për sigurimin e cilësisë.

- 1.7 Hapi i ardhshëm në këtë proces është që të mblidhen të dhënat e nevojshme duke përdorur mjetet e zhvilluara për keto qëllime.
- 1.8 Pas identifikimit të mjeteve dhe mekanizmave të nevojshme të sigurimit të cilësisë dhe pas marrjes së të dhënave të nevojshme për vetë-vlerësimin, komisionet duhet të analizojnë proceset që percaktojnë pikat e forta, dobësitë dhe arsyet për një rezultat të caktuar.
- 1.9 Diagrama e këtyre elementeve të përmbillet me vendosjen e lidhjeve midis rezultateve të marra si rezultat i vetëvlerësimit të rihvillimit të planeve, politikave dhe procedurave ekzistuese dhe zhvillimit të planeve, politikave dhe procedurave të reja.

2. Sigurimi i Cilësisë dhe qasja e të mësuarit me përqëndrim (focus) tek rezultati

- 2.1 Në mënyrë që dispozitat arsimore të jenë më të qëndrueshme dhe për të balancuar nevojat mes llogaridhënies dhe përmirësimit, universitetet duhet të zhvendosin qasjet e tyre ndaj proceseve të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, dhe, në një nivel strukturor, të mbështesin veprimtaritë mësimore dhe planifikimin e tyre në nivel fakulteti.
- 2.2 Për të siguruar krahasueshmërinë me qasjet evropiane dhe për të lehtësuar integrimin në HEAL,
 - fokusi në mësimdhënie dhe mësimnxënie duhet zhvendosur nga 'mësuesi në qendër' drejt qasjes 'studenti në qendër'.
 - sigurimi i cilësisë duhet të vlerësojë në mënyrë të qartë deri në çfarë mase universitetet përdorin:
 - mësimdhënien moderne dhe metodat e të mësuarit duke promovuar një qasje interaktive dhe pyetësore me studentin në qendër, në vend të një ligjerimi të thjeshtë;
 - një qasje të larmishme e të modernizuar të vlerësimit të studentëve që e lidh vlerësimin me rezultatet e synuara të mësimin.
- 2.3 Pika e nisjes në hartimin dhe vlerësimin e çdo programi dhe moduli akademik duhet të jetë në rezultatet e synuara të të mësuarit. Të gjitha inputet (metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, metodat e vlerësimit, stafi pedagogjik dhe burimet e të mësuarit) duhet të jenë të lidhura me rezultatet e synuara të mësimin dhe sigurimin e arritjes së këtyre rezultateve të të nxënies.
- 2.4 Metodatat e vlerësimit të studenteve duhet të mundësojnë matjen për këtë qëllim të arritjeve të këtyre rezultateve të të nxënies.
- 2.5 Kualifikimet e stafit mësimor vlerësohen sipas shkallëve që lejojnë matjen e rezultateve të veçanta mësimore të studentëve, ku rezultatet dhe objektivat janë të paracaktuara;

- 2.6 Burimet mësimore, disponibiliteti dhe efektiviteti i tyre, vlerësohen sipas shkallëve që lejon matjen e arritjeve të rezultateve të të nxënit.
- 2.7 Cilësia e dispozitave arsimore vlerësohet sipas shkallëve që lejojnë matjen e arritjeve të rezultateve të mësimin;
- 2.8 Kështu, treguesit kryesorë të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie duhet, ndër të tjera, të përqendrohen tek:
- a) **Metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies:** kur matet cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies, vëmendje të veçantë i duhet kushtuar shkallës në të cilën universiteti aplikon mësimin interaktiv dhe metodat e mësimdhënies me qendër studentin. Kjo përfshin ndërfutjen në mësimdhënie dhe mësimnxënie të elementeve që çojnë në formimin e aftësive të tilla tek studentët si: aftësia për të zgjidhur problemet, aftësia për të punuar në ekip, mënyra e duhur për të mësuar, përmirësimi i vazhdueshëm, përfitimi i njohurive ndërdisiplinore, ndërveprimi dhe përpunimi i informacionit, të mësuarit e teknologjive integrale, etj. Në këtë proces roli i lektorit duhet të jetë ai i një moderatori dhe/ose një udhërrëfyesi, dhe jo i një rrëfyesi.
 - b) **Synimi i rezultateve të mësimnxënies dhe vlerësimit të studenteve:** për të matur rezultatet e të mësuarit, vëmendje veçantë duhet t'i kushtohet (a) mësimdhënies së njehsuar dhe përparimit të studenteve; (b) punësimit të të diplomuarve; (c) kualifikimit të mësuesve dhe burimeve të mësimdhënies. Kur matet cilësia e mësimdhënies dhe e mësimnxënies, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nxitjes së konceptit të "vlerësimit të mësimnxënies" si një qasje e vlerësimit të studentëve që nxit formimin e rezultateve të të nxënit për sa i përket njohurive, kompetencave dhe aftësive, në vend të "vlerësimit të mësimnxënies" të thjeshtë, që nënkupton vetëm vlerësimin e performancës së studentit.
 - c) **Rezultatet e arritura të të mësuarit:** për matjen e arritjes së rezultateve mësimore, pika kryesore duhet të jetë rishikimi i projekteve të pavarura të studentëve (detyra kursi, punime studimi, teza, etj);
 - d) **Përvoja e studentit:** për matjen e përvojës së studentit, duhet të ndërmerren sondazhe me studentët dhe të diplomuarit.
- 2.9 Për të shkuar drejt një qasjeje vlerësimi ndaj rezultateve të të mësuarit në mësimdhënie dhe mësimnxënie, institucioni para së gjithash duhet të formulojë rezultatet e të mësuarit të destinuara për çdo program akademik dhe t'i bëjnë ato të dukshme e të matshme nëpërmjet projektimit të metodave të vlerësimit sipas qëllimit përkatës.
- 2.10 Me tej, duhet të zhvillohen sistemi përkatës i notave dhe kriteret e vlerësimit.
- 2.11 E njëjta logjikë duhet të aplikohet edhe për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kështu, hapi i parë duhet të jetë identifikimi i komponentëve kryesorë për

një cilësi më të mirë në lidhje me nevojat e mësimdhënies së njehsuar. Për shembull, komponentët kryesore për treguesin e cilësisë nr.1 (qasjes në mësimdhënie dhe mësimnxënie) janë ndërveprimi, puna e pavarur, zgjidhja e problemeve, puna në ekip, ndërveprimi dhe përpunimi i informacionit.

2.12 Komponentët kryesore për treguesin e cilësisë nr. 2 (rezultatet e synuara të mësimin dhe të vlerësimit të studentëve) janë: (a) përfshirja, (b) vlerësimi (assessability), (c) përmbajtja dhe niveli i rezultateve të të mësuarit të synuar dhe (d) rëndësia / aftësia për qëllimin e detyrave të provimit.

2.13 Përfshirja i referohet se deri në çfarë mase rezultatet e synuara të të mësuarit në kuadër të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve përputhen me ose përfshihen në rezultatet e synuara të të mësuarit në nivelin e programit akademik.

- Aftësia e vlerësimit (assessability) duhet të shihet si tregues kryesor i cilësisë në rezultatet e synuara të të mësuarit. Aftësia për vlerësim tregon deri në ç'masë janë të vlerësueshme rezultatet e synuara të të mësuarit dhe në cilën mënyrë ato mund të bëhen të vlerësueshme. Për këtë, ato duhet të përshkruajnë "përdorimin e dukshëm të njohurive", që përbën "kompetencën" - kombinimin unik të njohurive dhe aftësive. Kështu, kur përshkruajmë rezultatet e të mësuarit, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet dukshmërisë së tyre (studenti "i njeh dhe i kupton") dhe vlerësueshmërisë së tyre (të mësuarit është "të jesh në gjendje për të bërë" diçka me këtë njohuri).
- Përmbajtja akademike dhe niveli i një programi duhet të jenë në përputhje me objektivat e programit dhe në të njeten kohë në nivelin e duhur akademik, as shumë të lartë por as shume të ulët.
- Rëndësia / përshtatshmëria për qëllime të detyrave të provimit i referohet vlerësimit të studentëve, i cili duhet të jetë i projektuar në mënyrë të tillë për të siguruar që studentët të arrijnë rezultatet e synuara të mësimin. Kur vlerësohet cilësia e një programi vlerësimi, është e nevojshme vlerësimi i formës dhe përmbajtjes së metodave / detyrave të provimit. Kështu, edhe sipas një prej standardeve të ESG, kriteret e vlerësimit me nota duhet të bëhen publike për të nxitur me tej të mësuarin e studenteve.

2.14 Komponentët kryesore për treguesin e cilësisë Nr. 3 zhvillohen rreth vlerësimit të programit të studimit, që është cilësia e punës me studentët në vend të cilësisë së punës së studentëve.

- Për të përfshirë rezultatet e arritura mësimore në sistemet e sigurimit të cilësisë, IAL-t, së pari, duhet të zhvillojnë një model ku vlerësohet një nën-objekt i punës së studentit (p.sh. detyrat e kursit, tezat e diplomimit, projektet e pavarura, projekte të tjera shkollore) që nxjerr përfundime në lidhje me cilësinë e përgjithshme të programit akademik nën shqyrtim.

- Në mënyrë që të nxjerrë përgjithësime statistiki të sakta në lidhje me cilësinë e programeve individuale, është e nevojshme të merren kampione rastësore në sasi të mjaftueshme. Arritja e rezultateve të mësimnxënies duhet gjithashtu të fokusohet edhe tek studentët me rezultate të dobëta në projektet shkollore (që është mos-arritja e rezultateve të synuara) për t'i lejuar ose jo të kalojnë përmes sistemit.

2.15 Komponentët kryesore për treguesin e cilësisë nr. 4 zhvillohen rreth normave të kënaqësisë së studentit me mënyren e organizimit të programit, kualifikimet e arritura si dhe deri në çfare mase këto kualifikime kërkohen dhe janë të rëndësishme për tregun e punës.

3. Informacioni për studentët dhe një komunitet më të gjerë

- 3.1 Sistemet e brendshme të sigurimit të cilësisë së institucioneve shqiptare të arsimit të lartë duhet të sigurojnë informacione të besueshme mbi transparencën e dispozitave arsimore;
- 3.2 Çdo institucion duhet të ketë informacion, të detajuar dhe të besueshëm, në dispozicion të publikut për programet e studimeve individuale, fakulteteve dhe veçanërisht mbi cilësinë e programeve dhe niveleve institucionale;
- 3.3 IAL-et në Shqipëri duhet të sigurojnë që cilësia e informacionit i përshtatet interesave të një grupi të gjërë, edhe pse me interesa të veçanta, të cilat varen në diferencimin e perspektivave të palëve të interesuara të brendshme dhe të jashtme, të studentëve dhe të autoriteteve publike në veçanti. Diferencimi ka të bëjë me qëllimin për të cilin kërkohet informacioni, i cili përcakton llojin e informacionit që do të bëhet publik.
- 3.4 IAL-et në Shqipëri duhet të japin informacione për qëllimet e mëposhtme:
 - Për të zgjedhur një program akademik;
 - Për të zgjedhur një institucion;
 - Për të marrë vendime strategjike në nivele institucionale dhe në nivele sistemi;
 - Për të siguruar besimin në rezultatet e IAL-ve.
- 3.5 Informacionet që duhet të ofrohen janë:
 - Informacion mbi profilin dhe cilësinë e programeve dhe kualifikimeve;
 - Informacion mbi ecurinë dhe potencialin e institucionit;
 - Informacion mbi ecurinë e përgjithshme dhe potencialin e sistemit të arsimit të lartë;
 - Informacione, rekomandime apo rezultate të akreditimit që do të përdoren nga vendim-marrësit në krye të drejtimit të politikave të arsimit të lartë;
 - Informacione dhe udhëzime për studentët;
 - Vlerësime (te brendshëm dhe të jashtëm) dhe rekomandime me synimin për të ndihmuar strategjitë dhe veprimet e IAL-ve drejt përmirësimeve të vazhdueshme të

programeve;

- Standartet apo Renditjen përkatëse të zhvilluara me qëllim komunikimin e jashtëm.
- 3.6 Të gjitha aktivitetet që lidhen me sigurimin e cilësisë në IAL-et shqiptare ose dhënia e informacionit mbi cilësinë e arsimit të lartë duhet të respektojnë parimin e përshtashmërisë me qëllimin në fjalë.

III. Hartimi, miratimi, monitorimi dhe vlerësimi i programeve akademike.

1. Hartimi dhe miratimi i programeve akademike

- 1.1 Për zhvillimin e politikave dhe procedurave për hartimin, miratimin dhe shqyrtimin e programit së pari është e rëndësishme të shihet nëse janë marrë në konsideratë:
- pikat e jashtme të referimit (p.sh KKK), standartet akademike, kornizat kombëtare për kualifikimet e arsimit të lartë, dhe kur është e përshtatshme kërkesat e organeve profesionale, ligjore dhe rregullatore, punëdhënësit dhe çdo legjislacion përkatës kombëtar / angazhimet kombëtare në proceset Evropiane dhe ndërkombëtare.
 - faktorët e tregut të punës si arsytim kryesor për të propozuar një kurs / program të ri.
 - pajtueshmërinë e propozimeve dhe zhvillimeve të programit me qëllimet dhe misionet institucionale.
 - strategjitë akademike dhe planifikimin e burimeve.
 - dispozitat ekzistuese në kuadër të institucionit, përfshirë çdo diplomë që mund të ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera shqiptare ose të huaja.
 - nivelin e rrezikut që përfshihet në çdo proces miratimi / rishikimi dhe nivelin optimal të burimeve të nevojshme për të siguruar arritjen e rezultateve të kërkuara të procesit.
- 1.2 Institucioni duhet të sigurojë që përgjegjësia thelbësore e autoritetit akademik (p.sh. senatit apo bordit akademik) për të përcaktuar, mbajtur dhe siguruar standartet akademike respektohet dhe se çdo delegim pushteti nga autoriteti akademik tek të tretet për të miratuar ose shqyrtuar programe është e mire-përcaktuar dhe e mire-ushtruar.
- 1.3 Është e rëndësishme që rolet, përgjegjësitë dhe autoriteti respektiv i organeve të ndryshme që përfshihen në hartimin, miratimin, monitorimin dhe rishikimin e programit janë të përcaktuara qartë në mënyrë që stafi dhe studentët e përfshirë në procese të tilla janë të qartë në lidhje me hierarkinë e procedurave për të cilën ky organ do të marrë përgjegjësinë përfundimtare. Vlerësimi i çdo pushteti të deleguar është i rëndësishëm për të lejuar institucionin të sigurojë se proceset përkatëse vazhdojnë të funksionojnë në mënyrë efektive.
- 1.4 Sigurimi i pjesëmarrjes së ekspertëve të jashtëm në fazën kryesore për miratimin dhe

rishikimin e programeve është thelbësore. Pavarësia dhe objektiviteti janë të rëndësishëm për të siguruar besimin se standardet dhe cilësia e programeve janë të përshtatshme. Pjesëmarrja e ekspertëve të jashtëm është e rëndësishme për të siguruar një mendim të pavarur dhe transparent që konfirmon se programet janë hartuar, zhvilluar, miratuar dhe shqyrtuar në përputhje me standardet,. Pjesëmarrje e jashtme ofron siguri në nivele të ndryshme: për ekipin që merret me programin e dhënë, por dhe për vetë institucionin në monitorimin e pavarësisë dhe objektivitetit të vendimeve të marra në bazë të procedurave përkatëse; për studentët; dhe për çdo shqyrtues që kryen vëzhgimet/ auditivet e papërfshira në këto procese.

1.5 Institucioni duhet të sigurojë kontribute të jashtëm të përshtatshme me arritjen e synimit për zhvillimin, miratimin dhe rishikimin e programeve. Paneli i kontrolluesve të jashtëm, të ftuar për të kryer provimet përfundimtare të të diplomuarve, duhet të konsultohet në faza të ndryshme të miratimit dhe shqyrtimit të proceseve për marrjen e kontributeve të dobishme. Është gjithashtu e rëndësishme që kjo pjesëmarrje e jashtme të jetë proporcionale me nivelin, rëndësinë dhe kompleksitetin e procesit të ndjekur.

1.6 Institucionet duhet të kërkojnë kontribute të dobishme, për shembull nga:

- këshilltarët e jashtëm të cilët ofrojnë informacion relevant dhe udhëzime për zhvillimet aktuale në atë/ ato disiplina;
- kolegët akademikë nga disiplina të tjera brenda institucionit;
- çdo partner i programit, për shembull, institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi;
- studentët, që studiojnë në atë program ose ata me një rol përfaqësues të përshtatshëm;
- të diplomuarit e programit, punëdhënësit e tyre, shoqatat e duhura profesionale dhe sindikatat e punëdhënësve për të promovuar rëndësinë e programit / kursit për nevojat e tregut të punës;
- burimet e jashtme dhe këshilltarët të cilët ofrojnë informacione dhe udhëzime relevante për zhvillimet aktuale, duke përfshirë, për shembull, vendin e punës. Duke përdorur në mënyrën e duhur burimet e jashtme në procesin e hartimit, miratimit dhe shqyrtimit të programit një institucion që përfiton nga mundësitë për zgjerimin, si dhe për sigurimin.

1.7 Universiteti duhet të sigurojë që proceset për miratimin dhe rishikimin e programeve të kuptohen nga të gjithë ata që janë të përfshirë ose që kanë një interes në to, ndaj ky universitet duhet që:

- parimet dhe procedurat për miratimin dhe rishikimin e programeve t'i verë në dispozicion të të gjithë personelit dhe studentëve në institucion si dhe të pjesëmarrësve të jashtëm në këto procese, përfshirë proceset e vetë institucionit për të vendosur nëse do t'i grupojë së bashku programet për të rishikuar qëllimet ose për

t'i shqyrtuar ato në një mënyrë më të hollësishme dhe në mënyrë individuale;

- të deklarojë qartazi fazat e ndryshme të miratimit e rishikimit dhe përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive të pjesëmarrësve;
- të mirë-përcaktojë përgjegjësitë për inicimin e procesit të shqyrtimit kryesor, monitorimit dhe rishikimit të programeve;
- të mirë-përcaktojë strategjinë e zhvillimit të stafit dhe aktiviteteve që përfshijnë përhapjen e praktikës së mirë në lidhje me hartimin, miratimin, monitorimin dhe rishikimin e programit.

1.8 Hartimi i programit duhet bërë në një mënyrë që të lehtësojë shpërndarjen e rezultateve të synuara të mësimit dhe standarteve të kërkuara, që është thelbësore kur institucionet miratojnë programe të reja ose rishikojnë efektivitetin e programeve ekzistuese. Hartimi fillestar dhe miratimi i programeve duhet të jetë sa më rigoroz dhe efektiv në mënyrë që vlerësimet pasuese të mund të jenë relativisht të hapura. Dyfishimi i përpjekjeve dhe dokumentacionit mund të reduktohet me kërkesën e organeve të jashtme, të tilla si sindikatat profesionale dhe APAAL-i, dhe të merret parasysh kur programet janë hartuar, miratuar dhe shqyrtuar.

1.9 Hartimi dhe zhvillimi i duhur i një programi është vendimtar për të siguruar se ai është i përshtatshëm dhe i qëndrueshëm. Kjo gjë është gjithashtu e rëndësishme për shpërndarjen e sukseshme të tij. Kështu, proceset e hartimit duhet të jenë të mirë-menduar dhe të veprojnë efektivisht për të siguruar funksionimin e suksesshëm të procedurave të mëvonshme, të tilla si monitorimi dhe rishikimi. Parimet dhe pikat e referencës, të cilat duhet të merren parasysh në hartimin dhe zhvillimin e një programi të ri përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në to janë:

- qëllimet dhe misionin e institucionit;
- nevojat e tregut të punës dhe nevojat e studentëve;
- objektivat e synuara të programit;
- nivelin e programit - vlerat dhe epërsitë intelektuale - dhe vendi i tij në kuadrin kombëtar dhe / ose strukturat e kualifikimeve Europiane;
- pikat referuese të jashtme, duke përfshirë standartet akademike / rezultatet e mësimnxënies të përshtatshme, çdo pikë referuese evropiane, strukturat e kualifikimit për arsimin e lartë;
- rolin e studentëve në projektimin dhe zhvillimin e programeve;
- konceptin progresiv, në mënyrë që plani mesimor të imponojë një nivel të kërkesës në rritje për mësimnxënie gjatë rrjedhës së programit;
- mundësi, të cilat mund të jenë në dispozicion të studentëve për plotësimin e disa elementeve akademike dhe praktike të programit, për zhvillimin personal dhe

rezultatet akademike, shkallën e lartë dhe intesitetin e programit mësimor;

- lidhjen logjike të programit, për të siguruar se përvoja e përgjithshme e një studenti ka një logjikë dhe një integritet intelektual që janë të lidhura me qëllimet e përcaktuara në mënyrë të qartë;
- titullin e diplomes që akordohet, për të siguruar pasqyrimin e rezultateve të synuara mësimore të programit;
- se si do të promovohen, demonstrohen dhe vlerësohen rezultatet e synuara të të mësuarit të programit;
- se burimet e nevojshme janë të disponueshme për të përkratur programin.

1.10 Institucioni duhet të sigurojë se vendimet miratuese të programit janë në përputhje të plotë dhe marrin në konsideratë standartet akademike dhe përshtatshmërinë me mundësitë e mësimdhënies, të cilat do t' ofrohen studentëve. Vendimi përfundimtar për të miratuar një program duhet të merret nga autoriteti akademik, ose një organ që vepron në mënyrë të pavarur nga departamenti akademik, ose një sektor tjetër që ofron programin, dhe që ka qasje të plotë në çdo këshillë të nevojshme të specialistit.

1.11 Duhet të kete një proces konfirmimi, i cili tregon se një program i ka plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara gjatë procesit të miratimit dhe se gjatë shqyrtimit i janë dhënë të gjitha rekomandimet.

1.12 Në lidhje me përgjegjësinë e një institucioni të veçantë për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të diplomave të tij dhe në interes të transparencës, është e rëndësishme që të ketë një përcaktim të qartë të organit përgjegjës për miratimin e një programi dhe për sigurinë se të gjitha kushtet janë plotësuar përpara se ai program të fillojë.

1.13 Universiteti duhet të jetë i qartë për llojin e procesit që është i përshtatshëm për lloje të ndryshme miratimi, për shembull, për një program të ri, një modul të ri, ose një ndryshim në bilancin e vlerësimit brenda një moduli / sektori. Mund të jetë e dobishme që vendimi të bazohet në analizën e proporcionalitetit dhe rrezikut, nga institucionet, të cilat marrin vendime të informuara në lidhje me llojin e procesit dhe nivelin e jashtëm që do të jetë me i përshtatshëm.

1.14 Gjatë periudhës së hartimit, miratimit, dhe fillimit të një programi të ri, duhet të merren parasysh sa përmenden në vijim:

- parimet që mbështesin hartimin e programit;
- përcaktimin dhe përshtatshmërinë e standardeve në përputhje me nivelin dhe titullin e diplomës;
- burimet e nevojshme për të mbështetur programin;
- kërkesat e parashikuara për programin në nivelin e tregut të punës;
- monitorimin dhe rishikimin e rregullimeve për programin;

- kohëzgjatjen për të cilën është dhënë miratimi;
- përmbajtjen dhe specifikimet e programit;
- llojet dhe mundësitë e mësimnxënies të ofruara nga programi;
- zhvillimin e programit midis fillimit dhe miratimit të tij;
- lidhjen midis planit mësimor të programit dhe kërkimit shkencor aktual në të njëjtën fushë;

2. Monitorimi dhe rishikimi i programeve akademike

2.1 Për të siguruar se ka një cikël të vazhdueshëm zhvillimi, institucioni duhet të marrë parasysh dhe balancojë monitorimin rutinë me rishikimin periodik të programeve.

- Monitorimi periodik është aktiviteti që duhet të ndërmerret në kuadër të njësisë së sigurimit.
- Rishikimi periodik është procesi institucional, duke përfshirë pjesëmarrësit e jashtëm të rëndësisë së lartë dhe me besueshmëri akademike / profesionale. Në zhvillimin dhe vlerësimin e proceseve të tilla, institucionet duhet të jenë të sigurta që janë duke vëzhguar ndikimin në rritje të ndryshimeve.

2.2 Institucionet duhet të monitorojnë në mënyrë të zakonshme (në ciklin e pranuar) efektivitetin e programeve të tyre:

- për të siguruar që programet të mbeten aktuale, të vlefshme dhe të lidhura me nevojat e tregut të punës në dritën e zhvillimit të njohurive në disiplinën perkatese dhe praktikën në zbatim të tij;
- për të vlerësuar shkallën në të cilën rezultatet e synuara të të mësuarit po arrihen nga studentët;
- për të vlerësuar efektivitetin e vazhdueshëm të programit mësimor dhe të vlerësimit në lidhje me rezultatet e synuara të mësimit;
- për të siguruar se rekomandimet për veprimet e duhura janë ndjekur për të korrigjuar çdo mangësi të identifikuar.

2.3 Aktiviteti i monitorimit rutinë është përgjegjësi e njerëzve të cilët vlerësojnë performancën e tyre në fund të çdo viti akademik dhe gjatë procesit në vijim, për shembull, duhet të merren në konsideratë:

- raportet e kontrolluesve të jashtëm;
- çdo raport nga akreditimi ose organe të tjera të jashtme;
- stafi dhe reagimi i studentëve;
- reagimi nga ish-studentët dhe punëdhënësit e tyre mbi zbatueshmërinë e kualifikimeve në tregun e punës;

- progresi i studentit dhe të dhënat e tjera përkatëse;
 - materialet në dispozicion të studentëve, të tilla si specifikimet e programit, guida studentore dhe faqet e internetit.
- 2.4 Institucionet duhet të angazhohen në ndjekjen efektive dhe të shpejtë të çdo rekomandimi të bërë nga organet e jashtme për të mbrojtur interesat e studentëve aktualë dhe për të siguruar që zhvillimi i personelit dhe burimeve të tjera janë adresuar siç duhet.
- 2.5 Rishikimi i programit akademik është një mekanizëm tjetër i sigurimit të cilësisë. Momenti dhe natyra e rishikimeve varet nga një numër faktorësh. Këto faktorë përfshijnë shkallën e zhvillimit të dijes dhe praktikës në disiplinë, shkallën e trajtimit të çështjeve dhe qëllimeve të përgjithshme që shqyrtohen në kuadër të monitorimit rutinë dhe politikës së përgjithshme institucionale..
- 2.6 Institucionet duhet të sigurojnë që proceset e vlerësimit të mos kryhen në mënyrë të izoluar nga njëri-tjetri ose nga prioritetet e tjera institucionale.
- 2.7 Gjatë shqyrtimit periodik, universitetet duhet të vlerësojnë vlefshmërinë e vazhdueshme dhe rëndësinë e programit lidhur me nevojat e tregut të punës për arsye të tilla, për shembull, si më poshtë:
- efektin e ndryshimeve, duke përfshirë edhe ato të cilat janë kumulative dhe të bëra me kalimin e kohës, për hartimin dhe funksionimin e programit;
 - disponueshmërinë e vazhdueshme të stafit dhe të burimeve fizike;
 - hulumtimin dhe praktikën aktuale me qëllim zbatimin e njohurive në disiplinën/at përkatëse, përparimet teknologjike, si dhe zhvillimet në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
 - ndryshimet në pikat e jashtme të referencës;
 - ndryshimet në kërkesat e studentëve, prishmerite e punëdhënësve, mundësitë e punësimit dhe prirjet e tregut të punës;
 - të dhënat në lidhje me përparimin dhe arritjet e studenteve;
 - reagimet e studentëve.
- 2.8 Nëse universiteti mendon të ndërprerë një program, duhet të marrë masa për të njoftuar dhe për të mbrojtur interesat e studentëve të regjistruar ose të pranuar në të. Në këtë mënyrë institucionet janë përgjegjëse për menaxhimin e programeve të portofolit të tyre, përfshirë diplomat që ofrohen së bashku me institucione dhe partnerë të tjerë. Kjo mund të përfshijë ndërprerjen e programeve ekzistuese si dhe hartimin dhe zhvillimin e programeve të reja.
- 2.9 Institucionet duhet të sigurohen që procesi për ndërprerjen e rregullt të një programi është kryer, artikuluar dhe kuptuar njësoj si edhe ai për hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e nje programi.
- 2.10 Në rast të ndryshimeve të rëndësishme në karakterin e programit, institucioni të kryejë një

proces me qëllim menaxhimin në mënyrë të efektshme të këtij ndryshimi. Gjithashtu, ai duhet të jetë i qartë për atë që, në kontekstin e vet institucional, përbën një ndryshim të rëndësishëm në karakterin e programit dhe të mbajë të informuar partnerët bashkëpunues.

2.11 Institucionet të zotërojnë mjete për të vlerësuar proceset e hartimit, miratimit, monitorimit dhe praktikave rishikuese të programeve të tyre. Vlerësimi i proceseve duhet të sigurojë fokusin dhe duhet të lejojë institucionin të marrë në konsideratë:

- përfitimet e marra nga institucioni, stafi, studentët dhe të tretët nga miratimi, monitorimi dhe rishikimi i veprimeve të ndërmarra;
- se si rezultatet e proceseve nxisin rritjen e eksperiencave të të mësuarit të studentëve;
- identifikimin dhe përhapjen e praktikave të efektshme, si brenda ashtu edhe jashtë;
- mundësitë për t'i bërë më të efektshme dhe efikase praktikave të miratimit dhe rishikimit;
- nëse institucioni, nëpërmjet proceseve të tij, është duke përballuar në mënyrë të përshtatshme dhe proporcionale riskun për portofolin e programeve të tij.